



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovec/ Opštine Orahovac/ Municipality of Rahovec



Kryetari i komunës / Presednik Opštine/ Municipal Mayor

01Nr. 06
Me dt. 08.01.2019
Rahovec.

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës, nenit 29 paragrafit 1 të Rregullores së MAP-së nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M
Për anulimin e shpalljes së rekrutimit

I. Me këtë vendim APROVOHET raporti i Udhëheqësi të personelit i dt.27.12.2018 dhe ANULOHET shpallja e rekrutimit 01Nr.3104 i dt.22.11.2018 për pozitën: Udhëheqës të sektorit për gjeodezi pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për shkak se janë tejkaluar afatet e zbatimit të veprimeve të procedurës së rekrutimit.

II. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Udhëheqësi i personelit.

III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

IV. Me vendim të njihet Udhëheqësi i Personelit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe arkiva.

V. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të komunës dhe në tabelën e shpalljeve zyrtare .

